



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

Komuna e Suharekës  
Opština Suva reka  
Municipality of Suhareka



14. 01. 2025.

| REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS<br>REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA<br>REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA |                         |                              |                            |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|------------------------------|----------------------------|
| MARRE NË DORËZIM - PRILMJE NJË - RECEIVED                                                                                             |                         |                              |                            |
| Njësia Org.<br>Org. Juriçka<br>Org. Unit                                                                                              | Numri<br>Broj<br>Number | Shtesa<br>Prilog<br>Appendix | Vlera<br>Vrednost<br>Value |
| 01                                                                                                                                    | 052                     | 3/20                         | f                          |

01 Nr. 052-3120

Datë: 14.01.2025

## Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Suharekës

Raport vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe  
aktivitetet e auditimit të brendshëm

Për periudhën prej 01.01 deri 31.12.2024

Janar, 2025

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

|                                                                                |   |
|--------------------------------------------------------------------------------|---|
| 1. Hyrje.....                                                                  | 2 |
| 2. Llogaridhënia menaxheriale.....                                             | 2 |
| 3. Planifikimi i punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm.....               | 2 |
| 4. Rishikimi i zbatimit të rekomandimeve.....                                  | 4 |
| 5. Bashkëpunimi me Komitetin e Auditimit.....                                  | 4 |
| 6. Bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA)–Auditorin e Jashtëm..... | 5 |
| 7. Detyrat e Shërbimit Këshillues dhe aktivitete tjera të NJAB-ës.....         | 5 |

## **1. Hyrje**

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) në strukturën organizative të Komunës së është e sistemuar në kuadër të zyrës së Kryetarit të Komunës.

NJAB operon me një(1) auditore e cila është edhe Udhëheqëse e NJAB.

Duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-021, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, NJAB ushtron funksionin e saj në mënyrë të pavarur dhe i raporton drejtpërdrejt vetëm udhëheqësit të subjektit të sektorit publik dhe e njofton Komitetin e Auditimit. Në raport me strukturat tjera organizative në subjektin e sektorit publik, njësia për auditimin e brendshëm ka pavarësinë funksionale në planifikimin e punës së auditimit, në kryerjen e auditimit dhe në raportim.

Në harmoni me Udhëzimin Administrativ MF-NR.01/2019, për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik, me datën 08.07.2024, Kryetari i Komunës ka themeluar Komitetin e Auditimit (KA) si organ të pavarur këshillëdhënës për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik, dhe mbështetës për auditorët e brendshëm.

## **2. Llogaridhënia menaxheriale**

NJAB ka përgatitur një përmbledhje të aktiviteteve të kësaj njësie të cilat janë përfshirë në Raportin e Auditimit të Brendshëm për vitin 2024.

Udhëheqësja e NJAB-së rregullisht i raporton Kryetarit të komunës, si dhe Departamentit Qendror Harmonizues në Ministrinë e Financave, Transfereve dhe Punës (DQH/AB-MFTP), përmes Raporteve gjashtëmujore dhe Raportit Vjetor.

Për çdo raport individual të entitetit të audituar NJAB i raporton Kryetarit të komunës, ndërsa një kopje të raportit ia dorëzon edhe drejtorit të drejtorisë përkatëse.

Për periudhën raportuese, KA është njoftuar në kohë reale me aktivitetet e NJAB.

Raporti i gjashtëmujorit të parë dhe dytë si dhe Raporti vjetor i NJAB-së, për vitin 2024, është aprovuar nga Kryetari i Komunës, me kohë dhe është dorëzuar DQH/AB-MFTP, dhe gjithashtu është shqyrtuar edhe nga KA.

## **3. Planifikimi i punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm**

Në përputhje me Nenin 25 pika 3.3, të Ligjit Nr.06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, Drejtori i NJAB-së është i obliguar të bëjë përgatitjen dhe dorëzimin e Planit Strategjik dhe Planit Vjetor për rishikim dhe miratim tek udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe te Komiteti i Auditimit i cili obligim për vitin 2024 është kryer në kohë reale (në tremujorin e vitit 2024) nga Udhëheqësja e NJAB-së.

Pra, në tremujorin e katërt të vitit 2024, NJAB ka përgatitur dhe dorëzuar në DQH/AB-MFTP, Planin strategjik për periudhën 2024–2026 dhe Planin Vjetor për vitin 2024, duke u bazuar në rreziqet që ndikojnë në objektivat e Komunës.



Në kuadër të Planit Vjetor për vitin 2024 kanë qenë të planifikuara pesë (5) aktivitete audituese, të bazuara në vlerësimin e rrezikut sipas prioriteteve të përcaktuara nga shkalla e lartë e rrezikshmërisë (me koeficient nga 2.31 – 3), shkalla e mesme (me koeficient nga 1.71 – 2.30) dhe shkalla e ulët (me koeficient nga 1 – 1.70).

Plani Vjetor i NJAB-ës për vitin 2024 është ndryshuar për shkak të mungesës së auditorit.

Në kuadër të Planit Vjetor të NJAB-së përfshihet menaxhimi i kohës i cili kalkulohet për çdo aktivitet auditues, punë administrative, trajnime – aftësim të vazhdueshëm profesional si dhe hartimi i Planit Strategjik dhe Planit Vjetor. Po ashtu, përveç kohës së planifikuar për shfrytëzimin e të drejtës së pushimit/ve, planifikohet shfrytëzimi i të drejtës së menaxhmentit të lartë për kryerjen e auditimit me kërkesë.

Procesi i auditimit gjatë aktivitetit auditues realizohet në 4 faza: planifikim, terren, raportim dhe përcjellje. Ky proces reflekton planin e veprimit për aktivitetin auditues.

Ndërsa menaxhmenti përkatësisht entiteti i audituar ka për obligim që të hartojë Planin e Veprimit<sup>1</sup> për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NJAB.

Bazuar në Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, NJAB përgatit Orarin e përcjelljes<sup>2</sup> së zbatimit të rekomandimeve.

Në kuadër të Planit Vjetor për vitin 2024 janë të planifikuara pesë (5) auditime, por me ndryshimin e planit vjetor të punës për vitin 2024 janë planifikuar të kryhen tre (3) auditime.

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, NJAB ka përgatitur dhe dorëzuar në Departamentin Qendror Harmonizues, Planin strategjik për periudhën 2025 – 2027 dhe Planin Vjetor për vitin 2025, duke u bazuar në rreziqet që ndikojnë në objektivat e Komunës.

1. Kalkulimi dhe grumbullimi i të hyrave nga tatimi në pronë dhe taksave në aktivitete për subjektet afariste në Drejtorinë për Ekonomi Buxhet dhe Financa;
2. Menaxhimi dhe ruajtja e pasurisë jo financiare në Komunën e Suharekës;
3. Menaxhimi i buxhetit dhe shpenzimeve të QKMF-së në Drejtorinë e Shëndetësisë-QKMF "Rexhep Kuqi";
4. Menaxhimi i buxhetit dhe shpenzimeve për të gjitha kategoritë e shpenzimeve të arsimit në Drejtorinë e Arsimit;
5. Auditimit i performancës në menaxhimin e kontratave.

Në përputhje me Planin Vjetor për vitin 2024, në gjashtëmujorin e parë është kryer një (1) auditim dhe në gjashtëmujorin e dytë janë kryer dy (2) auditime dhe është bërë rishikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna për auditimet e kryera.

Auditimet e planifikuara dhe të realizuara gjatë vitit 2024, janë:

1. Kalkulimi dhe grumbullimi i të hyrave nga tatimi në pronë dhe taksave në aktivitete për subjektet afariste;
2. Menaxhimi dhe ruajtja e pasurisë jo financiare në Komunën e Suharekës;
3. Auditimit i performancës në menaxhimin e kontratave.

<sup>1</sup>Formulari Nr.3003 – Plan i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Auditimit sipas numrit përkatës të referencës.

<sup>2</sup>Formulari Nr.4001 – Orari i përcjelljes për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Auditimit sipas numrit përkatës të referencës.

Për tri (3) auditime të kryera janë hartuar raportet e auditimit dhe në total janë dhënë 12 rekomandime të cilat kanë qenë në përputhshmëri me të gjeturat e evidentuara në raport.

Në Raportet e Auditimit:

1. Kalkulimi dhe grumbullimi i të hyrave nga tatimi në pronë dhe taksat në aktivitetet për subjektet afariste: Ky aktivitet është realizuar në Drejtorinë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa, dhe janë dhënë dy (2) rekomandime për përmirësimin e këtij procesi.
2. Menaxhimi dhe ruajtja e pasurisë jo financiare: Aktiviteti është realizuar në Drejtorinë komunale përgjegjëse: Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa, Drejtoria e Arsimit, dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (përfshirë QKMF-në). Për këtë fushë janë dhënë gjashtë (6) rekomandime lidhur me menaxhimin e pasurisë jo financiare.
3. Auditimi i performancës në menaxhimin e kontratave: Aktiviteti është realizuar në Drejtorinë përgjegjëse për menaxhimin e kontratave, siç janë Drejtoria për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (përfshirë QKMF-në), si dhe menaxherët e kontratave. Për këtë aktivitet janë dhënë katër (4) rekomandime për përmirësimin e menaxhimit të kontratave.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, përveç Detyrave të Shërbimit të Sigurisë (DSHS), të realizuara nga NJAB, aktivitete tjera të cilat janë realizuar janë edhe Detyrat e Shërbimit të Sigurisë (DSHS), të cilat jo vetëm që i janë ofruar vetëm Kryetarit dhe drejtorëve të drejtorive komunale, por ato i janë ofruar edhe zyrtarëve komunal (shërbyesve civil).

Në përputhje me rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e NJAB, Detyra e Shërbimit të Sigurisë (DSHS) vazhdon të mbetet një aktivitet i vazhdueshëm cili vazhdimisht realizohet nga NJAB respektivisht nga auditori i brendshëm.

#### **4. Rishikimi i zbatimit të rekomandimeve**

Gjatë fazës së përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitin 2024, kemi verifikuar se prej dymbdhjetë (12) rekomandimeve të dhëna nga NJAB, katër (4) rekomandime apo 33.33% janë zbatuar, dhe tetë (8) rekomandime apo 66.66% janë në proces.

#### **5. Bashkëpunimi me Komitetin e Auditimit**

Duke u bazuar në Nenin 8 pika 5 e Udhëzimit Administrativ MF-NR.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik, NJAB ofron shërbimet e sekretarisë për Komitetin e Auditimit. Në këtë drejtim NJAB ka përgatitur të gjitha materialet e nevojshme për trajtim në kuadër të takimeve të mbajtura nga KA, brenda kësaj periudhe raportuese.



## **6. Bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA)–Auditorin e Jashtëm**

Gjatë procesit të aktivitetit auditues të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), Ekipi i Auditimit (EA) kërkon edhe raportet e auditimeve të kryera sipas Planit Vjetor të NJAB-së, të cilat Drejtori i NJAB ka për obligim që EA të ZKA-së t'ia dorëzoj kopjet e atyre raporteve, të cilat ne i kemi kryer në kohë reale.

Në Raportin e Auditimit të ZKA-së, të publikuar në qershor të vitit 2024, i cili raport i referohet vitit paraprak – vitit 2023, janë dhënë dhjetë (10) rekomandime, prej të cilave tri (3) rekomandime janë të reja, pesë (5) rekomandime të përsëritura, si dhe dy (2) pjesërisht të përsëritura.

## **7. Detyrat e Shërbimit Këshillues dhe aktivitete tjera të NJAB-ës**

Në muajin maj 2024, ka filluar puna e auditores së brendshme në Komunën e Suharekës. Aktivitetet kryesore janë si vijon:

- Përgatitja e detyrës së planifikuar për zhvillimin e aktivitetit të Auditimit të rregulltë me temën: "Kalkulimi dhe grumbullimi i të hyrave nga tatimi në pronë, taksave në aktivitetet për subjektet afariste për periudhën 01.05.2023-31.05.2024", në Drejtorinë për Ekonomi Buxhet dhe Financa. Kjo detyrë ka filluar me datën 31.05.2024;
- Ndryshimi i Planit vjetor të punës së NJAB për vitin 2024, (përgatitja e formularit për ndryshimin e Planit të auditimit);
- Rishikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna për auditimet e kryera në Zyren e Prokurimit, nga viti 2023 në 2024;
- Aktivizimi i qasjes në SIMFK për funksionin e kërkuar për pamje dhe raportim për auditorin nga Thesari i Kosovës;
- Aktivizimi i qasjes në Sistemin e Raportimit të NJQHAB nga Njësia e Aplikacioneve të Reja në MF (pilot projekt);
- Bashkëpunimi, konsultat dhe angazhimet e vazhdueshme me ekspertin e angazhuar nga projekti i USAID-it Integriteti i Komunave të Kosovës;
- Përgatitja e raportit gjashtëmujor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për periudhën prej Janar deri Qershor 2024 për NJQH të AB;
- Përgatitja e raportit gjashtëmujor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për periudhën prej 01.01 deri 30.06.2024 për ëeb faqe të Komunës;
- Përgatitja e Planit Vjetor për vitin 2025 për NJAB Komuna Suharekë dhe përcjellja në NJQH të AB;
- Përgatitja e Planit Strategjik për periudhën 2025-2027 për NJAB Komuna Suharekë dhe përcjellja në NJQH të AB;
- Pjesëmarrja në takimin e tremujorit të dytë të Komitetit të Auditimit të Brendshëm me 22.07.2024;
- Pjesëmarrja në takimin e tremujorit të tretë të Komitetit të Auditimit të Brendshëm me 30.10.2024;
- Pjesëmarrja në punëtorinë dy-ditore me temën "Avancimi i mëtejshëm i sistemeve të kontrollit të brendshëm në komunat e Kosovës", e mbajtur me datën 13-14.06.2024, të organizuar nga projekti DEMOS;
- Pjesëmarrja në punëtorinë me temën "Procesi i Auditimit" e mbajtur me datën 20.06.2024, të organizuar nga USAID-i, projekti: Integriteti i Komunave të Kosovës;

- Pjesëmarrja në takim me Kryetarin e Komunës dhe Drejtorët Komunal për shqyrtimin e draft-raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2023, me datën 19.06.2024;
  - Pjesëmarrja në trajnimin me temën: "Menaxhimi i Kontratave" të mbajtur me datë 02.08.2024, të organizuar nga USAID-i, projekti: Integriteti i Komunave të Kosovës;
  - Pjesëmarrja në trajnimin për zhvillimin e Sistemit Informativ për Raportimin e Auditimit të Brendshëm – SIRAB, në pilotimin e sistemit të organizuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në bashkëpunim me Departamentin Qendror Harmonizues dhe Departamentin e Menaxhimit të Sistemeve të IT, me mbështetje financiare nga USAID-i, të mbajtur më datën 09.10.2024;
  - Pjesëmarrja në punëtorinë me temën "Hapat e auditimit të performancës" e mbajtur me datën 28.10.2024, të organizuar nga USAID-i, projekti: Integriteti i Komunave të Kosovës;
  - Pjesëmarrja në punëtorinë "Metodologji e mostrimit në auditim" të mbajtur më 20 Nëntor 2024, të organizuar nga USAID KMI;
  - Pjesëmarrja në trajnimin për Auditimin e Performancës për auditorët e brendshëm të institucioneve të mbajtur më 21 nëntor 2024, të organizuar në bashkëpunim me USAID-in, NJQH-AB dhe IKAP;
  - Pjesëmarrja në punëtorinë për praktikat komunale të auditimit dhe ndikimin e raporteve të auditimit për vitin 2023, të mbajtur me 26 nëntor 2024, me Komunitatet e rajoneve të Prizrenit, të organizuar nga Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE);
  - Pjesëmarrja në trajnimin për "Sistemin Informativ për Raportimin e Auditimit të Brendshëm -SIRAB", të mbajtur me 4 dhjetor 2024, të organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) në bashkëpunim me Njësinë Qendrore të Harmonizimit\Auditimi i Brendshëm dhe Departamentin e TI-së\Divizioni i Aplikacioneve të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT);
  - Pjesëmarrja në Lansimin e Sistemit të Raportimit për Auditim të Brendshëm, të mbajtur me datën 19.12.2024, të organizuar nga USAID-i për Integritetin e Komunave në Kosovë (USAID KMI) në partneritet me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) dhe Njësinë Qendrore Harmonizuese
- Ofrimi i ndihmës profesionale të vazhdueshme për disa Drejtorë Komunalë që kanë shfaqur interesim dhe nevojë.

Data: 14.01.2025  
Komuna Suharekës

Luljeta Baraliu, \_\_\_\_\_  
Udhëheqëse e Njesisë së Auditimit të Brendshëm

